



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE
GRUPI PARLAMENTAR "DEMOKRAT"

Nr. ____ Prot.

Tiranë më 14/11/2019

Lënda: Kërkesë për shtyrjen e afatit të veprimtarisë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Realizimin e Reformës Zgjedhore"

Drejtuar:

Z. Gramoz RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Me vendimin Nr. 102/2017, datë 13.10.2017, Kuvendi i Shqipërisë vendosi krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Realizimin e Reformës Zgjedhore".

Në pikën X të këtij Vendimi, parashikohet që Komisioni do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 6 mujor nga data e miratimit të këtij vendimi.

Me Vendimin nr. 58, datë 29.03.2018, Kuvendi vendosi zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar Për Reformën Zgjedhore për një periudhë 4 mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.

Me vendimin nr. 89, datë 23.07.2018, Kuvendi vendosi zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore për një periudhë 6 mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.

Me vendimin nr. **23/2019**, Kuvendi vendosi zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore për një periudhë 1 mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.

Me vendimin nr. 49/2019, datë 25.04.2019, Kuvendi vendosi zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore deri në datën 28 nëntor 2019.


Me qëllim që veprimtaria e këtij Komisioni të Posaçëm Parlamentar të përmbushë të gjithë objektivat e përcaktuara nga Kuvendi, do të nevojitet më shumë kohë sesa u parashikua në vendimin nr. 49/2019.

Për këtë arsye, kërkojmë që në seancë plenare, Kuvendi të shqyrtojë dhe të miratojë projektvendimin bashkëlidhur për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për reformën Zgjedhore”, për një periudhë 3 –mujore, nga data e miratimit të Këtij vendimi.

Me konsideratë,

Taulant BALLA

Kryetar i Grupit Parlamentar



Arlind ÇAÇANI

Zëvendëskryetar e Grupit Parlamentar

